

Data 26.11.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Sherbim tre vjear konsulence administrative dhe fiskale

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

66171000-9

VLERA E FONDIT LIMIT:

13.966.667 (trembedhjete milion e nenteqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e shtatë) Leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Kjo pike plotësohet me dorezimin e *Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", i ndryshuar me VKM Nr. 211 date 09.04.2025.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023 dhe 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Perkatesisht të nenit 41, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar; b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit; c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 41, pika 3 për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen e nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme profesionale Kontabel i Miratuar të regjistruar pranë Organizatës së Profesionistëve të lirë për të paktën dy punonjës të tij me eksperience për një periudhë të paktën 10 vjetë, të cilët duhet të figurojnë dhe në listëpagesat e shoqërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe referuar Ligjit nr. 10091/2009 Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore të shoqëruar me listëpagesat, për përmbushjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, për fuqi punëtore të paktën 10 (dhjetë) punonjës rregullisht të punësuar, listëpagesat të jenë të konfirmuara pranë autoritetit perkates për periudhën Janar 2025 – Tetor 2025, për realizimin e objektit të prokurimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, përkatësisht Pjesa III DEKLARATË B Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Numri minimal prej 10 (dhjetë) punonjësish është përcaktuar duke u bazuar në natyrën dhe vëllimin e shërbimeve që kërkohen për realizimin e objektit të prokurimit, i cili përfshin angazhimin e kapaciteteve administrative, kontabël dhe teknike përgjatë një periudhe të vazhdueshme. Për të garantuar realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata, është vlerësuar se operatori ekonomik duhet të ketë një strukturë minimale funksionale, e cila të sigurojë disponueshmëri të vazhdueshme të stafit; mbulim të mjaftueshëm të funksioneve administrative, kontabël dhe të asistencës teknike; shmangie të rrezikut të vonësve për shkak të mungesës së burimeve njerëzore; kapacitet për të përballuar ngarkesën e punës që lidhet me shërbimin.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me programin financiar “Financa 5 Enterprise”, në versionin e avancuar, me kapacitet përdorimi për jo më pak se 5 (pesë) përdorues njëkohësisht. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturë blerjeje, deklaratë zotërimi, ose çdo dokument tjetër të vlefshëm që vërteton disponimin e programit nga ana e tij.

2.4.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një policë sigurimi në favor të Autoritetit Kontraktues për të mbuluar dëmet e shkaktuara nga neglizhenca, gabimet dhe / ose lëshimet e ofruesit dhe / ose punonjësve të tij në lidhje me aktivitetet që duhet të ofrohen.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojnë aftësi teknike dhe profesionale të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Detaje të shërbimeve të kërkuara të konsulencës administrative dhe fiskale, asistence me personelin dhe trajnime specifike.

Konsulencë kontabël periodike, konsulencë dhe asistencë në mbajtjen e regjistrit të asetëve dhe regjistrit të inventarit, raporte dhe analiza kontabël, nëpërmjet hartimit të raporteve provizore përgjatë vitit (si për shembull bilanc vërtetues, pasqyra e performancës, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e fluksit të parasë, raporte të konsoliduara, raporte menaxhimi të kërkuara nga aksionarët etj.), përgatitja e pasqyrave financiare, mbajtja e të gjitha deklarimeve tatimore të Shoqërisë (përveç deklarimeve dhe c'deklarimeve të punonjësve), kontrolle mujore të formalizuara të regjistrimeve kontabel dhe bankare. Asistencë ndaj audituesit për auditimin vjetor të pasqyrave financiare. Arkivim i dokumentacionit kontabel të shoqërisë. Konsulencë mbi kuadrin ligjor në fuqi (si edhe ndryshimet e ndodhura përgjatë kohës së vlefshmërisë së kontratës) në fushën kontabël dhe fiskale. Trajnim i personelit të Shoqërisë. Asistencë në përgatitjen e planeve ekonomike shumëvjeçare. Asistencë gjatë inspektimeve të Organeve të Kontrollit për çështjet kontabël dhe fiskale. Asistencë për marrëdhëniet me sistemin bankar dhe për menaxhimin dhe/ose marrjen e linjave të kredive, huave apo formave të tjera të financimit.

Asistencë për përgatitjen e të gjitha raportimeve të kërkuara nga ligji dhe nga Aksionarët e Shoqërisë, sipas llojit, formateve dhe afateve të percaktuara (mujore, tremujore, gjashtëmujore, nentemujore dhe vjetore).

Detaje të shërbimeve të kërkuara për përgatitjen e listës së pagave:

Supervizim i pagave në mbështetje të Legjislacionit në fuqi, implementimi në sistemin fiskal dhe printim në PDF i formularëve të pagesave të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore (maksimumi deri në 1000 punonjës në muaj) me kontrollin e raporteve mujore të orëve të punës, pagave bruto, orëve jashtë orarit, shtesave dhe zbritjeve të ndryshme, organizimin sipas mënyrave të pagesës. Përgatitja dhe deklarimi mujor i pagave. Asistencë për transmetimin e raportimeve periodike për zyrën e punës dhe inspektoratin e punës. Asistencë gjatë inspektimeve të Organeve të Kontrollit në fushën e përlllogaritjes së pagave.

Asistencë për procedurat e raporteve mjekësore, barrë lindjes dhe të tjera të lidhura me personelin sipas dispozitave ligjore të fushës.

Autoriteti Kontraktor disponon programin financiar Financa 5 dhe kërkohej që programi të azhurnohej në Financa 5 Enterprise i avancuar ku të mbahet inventari analitik i asetëve, inventari i pjesëve të kembimit me qendra kostoje për çdo mjet, inventari i karburantit me qendra kostoje ku të regjistrohet konsumi për secilin mjet, operatori ekonomik duhet të sigurojë aksesin në programin kompjuterik online për të gjitha të dhënat e kontabilitetit dhe inventarit. Programi financiar duhet të mundësojë importin e të dhënave shitje-blerje nga Platforma Qendrore e Faturave (Self Care) dhe levizjeve bankare nga sistemi bankar i Intesa San Paolo Bank në programin financiar.

Kohëzgjatja e shërbimit: Nga 01 Janar 2026 deri në miratimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin 2028 (maj 2029) nga Asambleja e Ortakëve.

Karakteristikat minimale të ofruesit të shërbimit

- Shoqëria të këtë staf të kualifikuar dhe zyrë në Tiranë.

Disponueshmëria e programit software që vijon: Financa 5 Enterprise i avancuar

- Ofruesi duhet të paraqesë një policë sigurimi në favor të Autoritetit Kontraktues për të mbuluar dëmet e shkaktuara nga neglizhenca, gabimet dhe / ose lëshimet e ofruesit dhe / ose punonjësve të tij në lidhje me aktivitetet që duhet të ofrohen.

- Në stafin e zyrës duhet të jenë të punësuar të paktën dy kontabël i miratuar (duhet te figurojne edhe ne listepagesat e shoqerise, me nje eksperience per nje periudhe te pakten 10 vjecare)

Kushtet e pagesës.

Fatura mujore (shërbim gjithëpërfshirës) do të paguhet në Bankën Intesa SanPaolo 60 ditë pas pranimi të faturës.

Raportet duhet te jene ne gjuhen shqip, italisht dhe anglisht dhe programi financiar Finaca 5 Enterprise i avancuar i mundesuar ne te pakten dy gjuhe shqip dhe italisht

Argumentimi: Në bazë të nenit 4, pikës 38b) dhe nenit 36 të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, janë hartuar specifikimet teknike të shërbimit të kërkuar duke argumentuar dhe detajuar çdo kërkesë dhe janë përcaktuar qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.